



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 138

21 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 654, datë 31.7.2013	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore “Krastë-Krujë”, Krujë, që do të përdoren nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror	6013
Vendim i KM nr. 655, datë 7.8.2013	Për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullosore “Mali i Rrencit - Kakarriq”, Lezhë, që do të përdoret nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror	6016
Vendim i KM nr. 656, datë 7.8.2013	Për rishpërndarje fondesh buxhetore për shpenzime korente, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e vitit 2013	6019
Vendim i KM nr. 657, datë 7.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për realizimin e procedurës së veprës monumentale, shtatore kushtuar figurës historike të Ismail Qemalit, me rastin e 100 - Vjetorit të Pavarësisë.....	6019
Vendim i KM nr. 658, datë 7.8.2013	Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare.....	6020
Vendim i KM nr. 659, datë 7.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Dalina Murana.....	6021

Vendim i KM nr. 660, datë 7.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Erblin Micaj.....	6021
Vendim i KM nr.661, datë 7.8.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave 110 kV dhe 220 kV që lidhin kaskadën e Devollit me sistemin e transmetimit të Republikës së Shqipërisë.....	6022
Vendim i KM nr. 665, datë 7.8.2013	Për miratimin e projektit pilot “Për masat për nxitjen e të nxënësve, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2013-2014”.....	6027
Vendim i KM nr. 666, datë 7.8.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, Gurëz, në komunën e Fushë-Kuqes të qarkut të Lezhës.....	6028
Vendim i KM nr. 667, datë 7.8.2013	Për lejimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për publikimin e njoftimeve për procedurën e prokurimit, me objekt “Rehabilitimi i ish - repartit ushtarak në qendër pritëse për të pastrehët”.....	6029
Vendim i KM nr. 668, datë 7.8.2013	Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	6030
Vendim i KM nr.695, datë 31.7.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Unaza e Madhe e Tiranës)”.....	6031

VENDIM
Nr. 654, datë 31.7.2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË
PYJORE “KRASTË-KRUJË”, KRUJË, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA
“SHPRESA-AL” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat 9/a, 99/b, 99/c dhe 100/a të ekonomisë pyjore “Kraštë-Krujë”, Krujë, gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) ha, që do të përdoren nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të gurit gëlqeror në vendburimin “Picragë”, të hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e sipërmendur të regjistrohet në kadastrën minerare, në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pronësi publike.

3. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll, djerr” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të gurit gëlqeror” sipas kondicioneve të projektit të parashtruar dhe planimetrisë bashkëlidhur, në përputhje me kërkesat e akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi për fondin pyjor.

4. Shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., të paguajë për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor tarifat e llogaritura sipas lidhjes 4, bashkëlidhur vendimit nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k. të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 3 (tri) viteve, sipërfaqen 19 (nëntëmbëdhjetë) ha, fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Mënyra e pyllëzimit dhe grafiku i punimeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek punimet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet tyre.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të reregjistrohet fond pyjor sipas mënyrës së rehabilitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Tabela 1

Nr.	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	Sipërfaqja që hiqet, ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor
1	EP. Krastë-Krujë	9/a	2.4	Pyll	Shkurre	Prodhues
2	EP. Krastë-Krujë	99/a	11.50	Pyll	Trungishte	Prodhues
3	EP. Krastë-Krujë	99/c	2.6	Djerr	Nuk ka	Prodhues
4	EP. Krastë-Krujë	100/a	2.5	Pyll	Trungishte	Prodhues
	Totali		19.00			





VENDIM
Nr. 655, datë 7.8.2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E
EKONOMISË KULLOSORE “MALI I RRENCIT - KAKARRIQ”, LEZHË, QË DO TË
PËRDORET NGA SHOQËRIA “COLACEM ALBANIA” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN
E GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar dhe në vijim të vendimit nr. 1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e fondit kullor”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat 4, 5/a, 5/b dhe 6 të ekonomisë kullorë “Mali i Rrencit - Kakarriq”, Lezhë, gjithsej 95 (nëntëdhjetë e pesë) ha, që do të përdoren nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të gurit gëlqeror në vendburimin “Mali i Kakarriqit”, të hiqen nga fondi kullor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqja nga fondi kullor dhe dhënia në përdorim shoqërisë “Colacem Albania” sh.p.k., të bëhet me pjesë, sipas madhësisë së sipërfaqes së miratuar në planin vjetor të punimeve të parashikuara në projekt.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të Fondit Kullor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave sipas pikës 1, të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe e regjistron në “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të gurit gëlqeror” sipas kondicioneve të projektit të parashtruar dhe planimetrisë bashkëlidhur, në përputhje me vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e fondit kullor”.

3. Shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Të ndërpriten dhënia në përdorim e pjesës tjetër dhe vazhdimi i punimeve në vitin pasardhës në qoftë se shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., nuk ka kryer rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar më parë.

4. Vlera e sipërfaqes kullorë të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4 bashkëlidhur vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., të përmirësojë me fondet e veta, brenda 3 (tri) viteve, 95 (nëntëdhjetë e pesë) ha, fond kullor, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor në bashkërendim me komunën Balldre.

Mënyra e përmirësimit të kullotës, grafiku i punimeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor dhe komuna Balldre, të cilat ndjekin punimet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së përmirësuar, sipas marrëveshjes që do të lidhet me kërkuesin.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të hiqet nga kadastra minerare dhe të reregjistrohet fond pyjor dhe kullor sipas mënyrës së rehabilitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, komuna Balldre dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela 1

Nr.	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	Sipërfaqja që hiqet, ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor	Pronësia
1	EK. Mali i Rrencit-Kakarriq	4	14.000	Kullotë	Kullotë	Kullotë	Komuna Balldre
2	EK. Mali i Rrencit-Kakarriq	5/a	50.000	Kullotë	Kullotë	Kullotë	Komuna Balldre
3	EK. Mali i Rrencit-Kakarriq	5/b	0.000	Kullotë	Kullotë	Kullotë	Komuna Balldre
4	EK. Mali i Rrencit-Kakarriq	6	31.000	Kullotë	Kullotë	Kullotë	Komuna Balldre
	Totali		95. 000				



HARTA TOPOGRAFIKE ME KOORDINATAT E ZONËS SË KËRKUAR PËR LEJE SHFRYTËZIMI
SHKALLA 1:25000



ZONA E KËRKUAR PËR LEJE SHFRYTËZIMI "COLACI" ALBANI				
Shprehje në 800m				
Koordinatat e pikave				
Pikë	V	V	V	V
1	4 384 664.45	4 637 142.35	16	4 386 286.61
2	4 384 930.00	4 636 600.00	17	4 386 312.27
3	4 385 071.00	4 636 346.00	18	4 386 344.26
4	4 384 835.00	4 636 200.00	19	4 386 376.85
5	4 385 188	4 635 802	20	4 386 400.62
6	4 385 348	4 635 567	21	4 386 408.25
7	4 385 569	4 635 704	22	4 386 476.46
8	4 385 822	4 635 359	23	4 386 499.18
9	4 385 816	4 635 331	24	4 386 525.02
10	4 385 975.00	4 635 170.00	25	4 386 547.97
11	4 386 046.00	4 635 158.00	26	4 386 609.78
12	4 386 137.73	4 624 376.61	27	4 386 674.39
13	4 386 193.70	4 634 890.74	28	4 386 645.00
14	4 386 253.46	4 624 836.65	29	4 384 735.00
15	4 386 263.49	4 634 826.60	30	4 384 357.23

VENDIM
Nr. 656, datë 7.8.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE PËR SHPENZIME KORENTE,
NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE
SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korente, ndërmjet programeve të miratuara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda buxhetit të vitit 2013, si më poshtë vijon:

a) Programit “Mbrotja sociale”, tit. 10 430, kap. 1, art. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i shtohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë.

b) Programit “Tregu i punës”, tit. 10 550, kap. 1, art. 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i pakësohet fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 657, datë 7.8.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E
PROCEDURËS SË VEPRËS MONUMENTALE, SHTATORE KUSHTUAR FIGURËS
HISTORIKE TË ISMAIL QEMALIT, ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi total prej 6 680 000 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për realizimin e procedurës së veprës monumentale, shtatore, kushtuar figurës historike të Ismail Qemalit me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.



3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 658, datë 7.8.2013

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT
DHE KAPACITETEVE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT NË QENDRAT SPITALORE
UNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësia bazë e fakultetit në qendrën spitalore universitare përbëhet nga “shërbime”, të cilat janë njësi diagnostikuese dhe mjekuese themelore dhe formohen në bazë specialiteti.

2. Shërbimet në qendrat spitalore universitare ndahen në shërbime me shtretër dhe shërbime pa shtretër.

3. Shërbimi me shtretër në qendrat spitalore universitare ka jo më pak se 30 (tridhjetë) shtretër.

4. Shërbimi duhet të ketë shfrytëzim shtrati mbi 85%.

5. Shërbimi duhet të ketë në përbërje të tij të paktën dy anëtarë efektivë si personel pedagogjik me tituj shkencorë.

6. Numri i personelit mjekësor, që shërben në shërbimet e qendrës spitalore universitare, bazuar në numrin e shtretërve, miratohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

7. Vendimi nr. 771, datë 7.11.2012 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 659, datë 7.8.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASES
DALINA MURANA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Dalina Murana.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 660, datë 7.8.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
SHETASIT ERBLIN MICAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 8 435 000 (tetë milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Erblin Micaaj.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 661, datë 7.8.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE 110 KV DHE 220 KV QË LIDHIN KASKADËN E DEVOLLIT ME SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave 110 kV dhe 220 kV që lidhin kaskadën e Devollit me sistemin e transmetimit të Republikës së Shqipërisë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 153 923.80 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë) lekësh.

4. Fondi prej 2 153 923.80 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë) lekësh të përballohet nga fondet e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 446 960 (katërqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë më 1 shtator 2013.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., Tiranë, në bashkëpunim me shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, në bashkëpunim me shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të projektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. Tiranë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të projektit në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. Tiranë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
LINJËS 110 KV CËRRIK - BANJË

Qarku Elbasan
Komuna Gostime

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësimit definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit	
Fshati Malasej												
1	33	Bashkim	Sali	Kamami	Arë	2559	24/7	4809	64.0	536	34304.0	
2	31	Mehdi	Mesut	Hoxha	Arë	2559	113/22	1546	47.0	536	25192.0	
3	32	Shaqir	Selim	Hoxha	Arë	2559	31/3	3000	47.0	536	25192.0	
					Arë			S =	158.0	S =	84688.0	
Fshati Shtërmën												
1	23	Robert	Venemin	Xhania	Arë	3422	224/45	2750	78.0	553	43134.0	
2	25	Agron	Jorgji	Mema	Arë	3422	237/24	3150	87.0	553	48111.0	
3	22	Robert	Kostandin	Musteqja	Arë	3422	291/3	1436	51.0	553	28203.0	
								S =	216.0	S =	119448.0	

Qarku Elbasan
Bashkia Cërrik

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										SHËNIME
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësim definitiv m²	Çmimi i tokës lekë/m²	Vlera e kompensimit	
Fshati Cërrik 2												
1	42	Xhevrije	Qemal	Rusi	Truall	2281	263/3	3717	83.0	2,200	182600.0	
2	41	Sije	Shane	Isaj	Truall	2281	285/8	3677	1.8	2,200	3960.0	
3	41	Ylvie	Ferui	Isa	Truall	2281	285/9	3677	110.2	2,200	242440.0	
4	40	Besnik	Sali	Carciu	Truall	2281	288/7	5734	55.0	2,200	121000.0	
5	34	Nebi	Naim	Omeri	Truall	2281	295/4	4530	15.5	2,200	34100.0	
6	36	Haxhie	Hysen	Cekrezi	Truall	2281	295/6	1515	23.9	2,200	52580.0	
7	36	Koze	Ymer	Cekrezi	Truall	2281	295/7	3030	36.1	2,200	79420.0	
8	35	Shaban	Ramazan	Nasufi	Truall	2281	296/6	5452	64.0	2,200	140800.0	
9	34	Shefikat	Beqir	Rabushja	Truall	2281	297/24	2500	48.5	2,200	106700.0	
10	37	Luljeta	Vasfi	Alushi	Truall	2281	301/21	3682	64.0	2,200	140800.0	
11	37	Zana	Demir	Mustafaj	Truall	2281	301/22	2212	6.0	2,200	13200.0	
								S =	508.0	S =	1117600.0	

Shuma, sipërfaqe m²		882.00	Total	1,321,736.00	Lekë
---------------------	--	--------	-------	--------------	------



LISTAT E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE 110 KV DHE 220 KV QË LIDHIN KASKADËN
E DEVOLLIT ME SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Qarku Elbasan
Komuna Kodovjat

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësimit definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit	
Fshati Bersnik i Poshtëm												
1	76	Selman	Sulo	Cani	Arë	1165	26/1	3,500	167.00	150.00	25,050.00	
2	78	Shefit	Sali	Tafa	Arë	1165	42/2	3,775	150.00	150.00	22,500.00	
3	77	Ramazan	Myftar	Myrtezai	Arë	1165	56/6	4,400	124.70	150.00	18,705.00	
4	79	Gani	Sulejman	Tafa	Arë	1165	8/5	5,650	107.00	150.00	16,050.00	
						S =	548.70		S =	82,305.00		
Fshati Bulcar												
1	71	Bajram	Skender	Bujku	Arë	1308	32/2	3,150	100.00	147.00	14,700.00	
2	70	Shaqir	Xhezar	Dermyshe	Arë	1308	42/27	5,950	96.50	147.00	14,185.50	
						S =	196.50		S =	28,885.50		
Fshati Kodovjat												
1	74	Bajram	Rexhep	Xheka	Arë	2188	89/36		75.00	173.00	12,975.00	
2	74	Nuri	Riza	Kume	Arë	2188	89/35		75.00	173.00	12,975.00	
3	75	Naiz	Fevzi	Hysa	Arë	2188	82/53		144.00	173.00	24,912.00	
4	89	Hyqmet	Servet	Koci	Arë	2167	73/4		138.00	173.00	23,874.00	
						S =	75.00		S =	74,736.00		
Fshati Mashan												
1	80	Misir	Nazmi	Dermyshe	Arë	2607	136/6	2,525	107.00	199.00	21,293.00	
2	81	Farik	Ramadan	Lena	Arë	2607	164/15	3,424	10.40	199.00	2,069.60	
3	84	Veiz	Xhezo	Hoxha	Arë	2607	36/17	4,160	139.10	199.00	27,680.90	
4	82	Nuri	Myftar	Myrtezani	Arë	2607	56/31	7,000	154.00	199.00	30,646.00	
						S =	410.50		S =	81,689.50		
Fshati Bratile												
1	101	Bashkim	Hysen	Balliu	Pyll	1362	12/12	50,000	100.00	188.00	18,800.00	
2	103	Bardhyl	Muhamet	Guri	Pyll	1362	186/1	220,000	114.00	188.00	21,432.00	
						S =	214.00		S =	40,232.00		
Fshati Kokel												
1	67	Muhabet	Bexhet	Shqipe	Arë	2197	9/23	5,100	147.50	189.00	27,877.50	
						S =	147.50		S =	27,877.50		

**Qarku Elbasan
Komuna Pishaj**

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësim definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit	
<i>Fshati Cingar</i>												
1	116	Rrapush	Jonuz	Zogu	Arë	1409	11/3	4,500	150.00	184.00	27,600.00	
2	115	Rustem	Bajram	Lumshi	Arë	1409	43/1	2,280	110.00	184.00	20,240.00	
								S =	260.00	S =	47,840.00	

<i>Fshati Kotorr</i>												
1	108	Servet	Sheme	Kotorri	Arë	2249	91/10	10,250	100.00	174.00	17,400.00	
								S =	100.00	S =	17,400.00	

<i>Fshati Qerret</i>												
1	104	Qamil	Muhamet	Guri	Pyll	2967	86/1	220,000	107.00	161.00	17,227.00	
								S =	107.00	S =	17,227.00	

**Qarku Elbasan
Komuna Tregan**

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësim definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit	
<i>Fshati Trepsenisht</i>												
1	139	Prezi	Llazar	Kaci	Arë	3640	109/16	4,925	2.60	244.00	634.40	
2	139	Prezi	Llazar	Kaci	Arë	3640	109/16	4,925	119.60	244.00	29,182.40	
								S =	122.20	S =	29,816.80	

<i>Fshati Tudan</i>												
1	141	Xhevit	Qamil	Cekini	Arë	3655	32/1	2,750	94.80	335.00	31,758.00	
								S =	94.80	S =	31,758.00	

<i>Fshati Cikallesh</i>												
1	133	Saip	Musa	Tashi	Arë	1407	87/4	13,800	94.00	355.00	33,370.00	
								S =	94.00	S =	33,370.00	

<i>Fshati Mucan</i>												
1	130	Selman	Haxhi	Idrizi	Arë	2727	190/1	18,700	99.00	190.00	18,810.00	



2	128	Hasan	Haxhi	Idrizi	Arë	2727	190/3	39,425	117.00	190.00	22,230.00	
3	129	Hasan	Haxhi	Idrizi	Arë	2727	190/3	39,425	114.00	190.00	21,660.00	
4	127	Nevruz	Selim	Idrizi	Arë	2727	197/14	14,975	167.00	190.00	31,730.00	
S =									330.00	S =	94,430.00	
<i>Fshati Kacivel</i>												
1	117	Sejdin	Zenun	Karaj	Arë	2018	46/51	2,150	158.30	207.00	32,768.10	
S =									158.30	S =	32,768.10	
<i>Blerimas</i>												
1	119	Xhevahir		Llapushi		1213	127/5	1,925	167.00	266.00	44,422.00	
S =									167.00	S =	44,422.00	

Qarku Elbasan
Komuna Shirgjan

Nr.	Nr. i shtyllës	Shpronësimi definitiv										Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sasia e sip. së pronës m²	Sipërfaqe shpronësim definitiv m²	Çmimi i tokës lekë /m²	Vlera e kompensimit	
Fshati Kryezjarrth												
1	143	Dhimiter	Vasil	Zela	Arë	2296	140/3	2,800	150.00	443.00	66,450.00	
2	146	Josif	Thelip	Bica	Arë	2296	80/8	10,750	2.20	443.00	974.60	
3	145	Dhimiter	Thanas	Bica	Arë	2296	85/10	5,250	19.50	443.00	8,638.50	
4	145	Petrit	Jorgji	Bica	Arë	2296	85/11	2,125	99.50	443.00	44,078.50	
5	144	Nosi	Spiro	Dedja	Arë	2296	89/32	1,540	46.90	443.00	20,776.70	
6	144	Pal	Spiro	Dedja	Arë	2296	89/33	2,600	14.70	443.00	6,512.10	
S =									332.80	S =	147,430.40	
Shuma, sipërfaqe m²								1,671.30	Total	832,187.80	Lekë	

VENDIM
Nr. 665, datë 7.8.2013

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT “PËR MASAT PËR NXITJEN E TË NXËNIT,
VIJUESHMËRISË DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE ROMË DHE EGJIPTIANË TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN SHKOLLOR 2013-
2014”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të 312 (treqind e dymbëdhjetë) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2013-2014.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore, që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës në formën e shërbimit ushqimor ditor të pakeluar për çdo nxënë për 170 (njëqind e shtatëdhjetë) ditë mësimore, jepet sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, në fillim të vitit shkollor, duhet të dërgojë pranë njësisë bazë të qeverisjes vendore, bashkisë Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursa/kuotat ushqimore rialokohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo bashki.

5. Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, bashkia Korçë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PASQYRA NR. 1
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI MËSIMOR 2013-2014)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/njësi	Vlera ditore/në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheger	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6
7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	Kuota ditore			912.45		76

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme, çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

VENDIM
Nr. 666, datë 7.8.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, GURËZ, NË KOMUNËN E FUSHË-KUQES TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike Gurëz, në komunën e Fushë-Kuqes, të qarkut të Lezhës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Fushë-Kuqes.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 3 499 (tri mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², tokë arë, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 1 179 163 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 179 163 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i planifikuar për komunën e Fushë-Kuqes.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Fushë-Kuqes.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Fushë-Kuqes, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3 499 (tri mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Fushë-Kuqes, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Fushë-Kuqes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE GURËZ” NË KOMUNËN E FUSHË-KUQES, QARKU LEZHË

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Sip. arë m ²	Çmimi, lekë/m ²	Vlera në lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Dok. i pronësisë
1	Lek Mirash Huli	3 499	337	1 179 163	54/10	1890	Certifikatë pronësie
	Totali	3 499		1 179 163			

VENDIM

Nr. 667, datë 7.8.2013

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA PËR PUBLIKIMIN E NJOFTIMEVE PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “REHABILITIMI I ISH-REPARTIT USHTARAK NË QENDËR PRITËSE PËR TË PASTREHËT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për publikimin e njoftimeve për procedurën e prokurimit, me objekt “Rehabilitimi i ish-repartit ushtarak në qendër pritëse për të pastrehët”.



2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 668, datë 7.8.2013

PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESES DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakët e Forcave të Armatosura trajtohen me ushqim të gatuar sipas normës së repartit vetëm në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi (gatishmërie, stërvitjeje, fushime).
 2. Në asnjë rast, trajtimi me ushqim nuk konvertohet në kompensim financiar për ushqim.
 3. Pikat 3, 4, 4/1, 5, 6 dhe 7, të vendimit nr. 524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohen.
 4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 695, datë 31.7.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT (FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË - UNAZA E MADHE E TIRANËS)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Unaza e Madhe e Tiranës)".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 200 603 463 (dyqind milionë e gjashtëqind e tri mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, dhe për objekte me vlerë 20 212 834 (njëzet milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e plotë e shpronësimit, prej 220 816 297 (dyqind e njëzet milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet në masën 136 904 720 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekë nga zëri "Fondi i shpronësimeve", në llogarinë e veçantë të Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, ndërsa pjesa e mbetur, në masën 83 911 577 (tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, do të përballohet sipas mënyrës që do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Vlera e vënë në dispozicion, në masën 136 904 720 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekë, do t'u paguhet pronarëve të shpronësuar në përpjesëtim të drejtë me masën përkatëse që u takon, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 890 000 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.8.2013.

7. Për objektet, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi "Proces legalizimi", poseduesit e këtyre objekteve të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe ai i regjistrimit pranë ZVRPP-së Tiranë, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga kjo e fundit, si dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë ARSH-së.

8. Për pasurinë me pronar "të papërcaktuar", për të cilën është bërë shënimi "Konflikt gjyqësor", të likuidohet, për efekt shpronësimi, personi i cili do të rezultojë pronar me vendim të formës së prerë të gjykatës, kjo në përputhje me nenin 16/2, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë ligjor, që do të dorëzojë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7, 8 e 9 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.



10. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE PROJEKTEVE TE HUAJA, TE BRENDSHME DHE SHPRONESIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NE SEGMENTIN RRUGOR
"ZGJERIMI I RRUGES SE ELBASANIT" (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE TIRANE)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurise	Siperfaqja (m2)	Çmimi (lek/m2)	Vlera (leke)	Shenime
	TIRANE Z.K. 8160								
1	Bashkepronesi Visari			8160	5/106	18	28960	521280	Konfirmuar nga ZVRPP
	TIRANE Z.K. 8280								
2	Lavdie		Caushi	8280	2/152	72	28960	2085120	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Bashkepronaret Zadeja & Radovick			8280	2/318	1050	28960	30408000	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Bashkepronaret Mita & Bejleri			8280	2/182	453	28960	13118880	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Bashkepronaret Tundo			8280	2/183	112	28960	3243520	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Tomson		Xhelili	8280	2/329	246	28960	7124160	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Vitore		Gruhn	8280	2/137	204	28960	5907840	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Luka Rashkovic			8280	2/116	57	28960	1650720	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Bashkepronaret Kondi, Kasa, etj			8280	2/112	33	28960	955680	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Bashkepronaret Bujari			8280	2/190	705	28960	20416800	Konfirmuar nga ZVRPP
	TIRANE Z.K. 8190								
11	Liza		Mati	8190	9/2	39	28960	1129440	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Liza		Mati	8190	9/3	84	28960	2432640	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Liza		Mati	8190	9/16	44	28960	1274240	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Liza		Mati	8190	9/18	29	28960	839840	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Liza		Mati	8190	9/25	27	28960	781920	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Liza		Mati	8190	9/26	15	28960	434400	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Liza		Mati	8190	9/114	181	28960	5241760	Konfirmuar nga ZVRPP

18	Shoqeria "Ferald" Shpk		8190	11/361	1364	28960	39501440	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Liman	Gjoka	8190	11/858	370	28960	10715200	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Andi	Gjoka	8190	11/853	611	28960	17694560	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Hysni	Miha	8189	11/368	17	28960	492320	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Hysni	Miha	8190	11/854	154	28960	4459840	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Gjergj	Gjeloshaj	8190	11/359	46	28960	1332160	Konfirmuar nga ZVRPP
24	I papercaktuar		8190	11/357	294	28960	8514240	Konflikt Gjyqesor
25	Bp. Stermasi, Mulleti, etj		8190	11/356	43	28960	1245280	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Bp. Stermasi, Mulleti, etj		8190	11/450	142	28960	4112320	Konfirmuar nga ZVRPP
27	Bp. Stermasi, Mulleti, etj		8190	11/451	244	28960	7066240	Konfirmuar nga ZVRPP
	FSHATI SAUK Z.K. 3266							
28	"Krels Luck" Shpk		3266	24/13	283	2751	778533	Konfirmuar nga ZVRPP
29	"Krels Luck" Shpk		3266	24/5	61	2751	167811	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Artan	Burda	3266	24/14	759	2751	2088009	Konfirmuar nga ZVRPP
31	Ferit	Leka	3266	24/12	1553	2751	4272303	Konfirmuar nga ZVRPP
32	Gezim	Rama	3266	70/10	79	2751	217329	Konfirmuar nga ZVRPP
33	Fiqiri	Dallashi	3266	70/2	138	2751	379638	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI				9527		200603463	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Objektet qe shpronsohen si rezultat I ndertimit te aksit
"ZGJERIMI I RRUGES SE ELBASANIT "
Lloji i pasurise se paluajtshme:Objekte

TABELA PERMBLEDHESE

Nr.	Pronari		Z. K	Nr. Pas.	OBJEKTE Vlera ne leke Sipas preventivit	EMERTIMI OBJEKTEVE	Shenim
	Emri	Mbiemri					
1	GJERGJ	GJELOSHI	8190	11/359	1.817.913	SISTEMIME DHE MUR RRETHUES	Proces legalizimi
2	ARTUR	MILANI	8190		7.105.690	DYQANE	Proces legalizimi
3	SKENDER	BRAHJA	3266		6.945.697	DYQANE	Proces legalizimi
4	SKENDER	BRAHJA	3266		1.809.471	ZYRA	Proces legalizimi
5	SKENDER	META	3266		2.534.063	GOMISTERI	Proces legalizimi
		TOTALI			20.212.834		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 21.8.2013
Doli nga shtypi më 21.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 32 lekë